



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:207090

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06154947

**Ca.nr.7946/24**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Enes Mehmeti kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.GJ nga fshati Strelc i Ulët, Komuna Deçan Rr “ Naim Gjukaj” , të cilin e përfaqëson Nasuf Hasani avokat në Prishtinë, Rr. “Luan Haradinaj” Hyrja 128, nr.1, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. A . KEDS me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton nr.3, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fllanza Hashani, për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga i autorizuari i paditëses, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1013/16, I datës 03.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë **10.09.2024**, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e paditësit H.GJ nga fshati Strelc i Ulët, Komuna Deçan Rr “ Naim Gjukaj”, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1013/16 i datës 03.11.2020, dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit Hamdi Gjuka kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës- Prishtinë, për anulim vendimi dhe kthim në punë.

Kundër këtij aktvendimi, në afat ligjor kanë paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore , konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë që aktvendimi i atakuar të priset dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Përgjigje ne ankesë ka parashtruar e paditura me propozimin që aktvendimi i shkallës së parë të vërtetohet ndërsa ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të LPK-së dhe vlerësimit të shkresave tjera lëndore, ka gjetur se:

**Ankesat është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi kundër të paditurës ka ushtruar padi për anulimin e vendimit dhe kthim në punë.

Gjykata e shkallës së parë me datë 03.11.2020 e ka nxjerr aktvendimin e atakuar me të cilin e ka konsideruar si të tërhequr padinë e paditësit, me arsyetimin se i autorizuari i paditësit ndonëse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregulltë për seancën e datës 03.11.202020 i njëjti nuk ka prezantuar në seancë e as arsyetuar mungesën e tij.

Kolegji i gjykatës së Apelit duke vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar karshi pretendimeve ankimore të ngritura me ankesën e paditësit kundër aktvendimin për tërheqjen e padisë, ka gjetur se i njëjti është i parregullt dhe i paligjshëm duke qenë se është nxjerr me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike me çka është përfshirë në cenim të dipozitave nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK-së.

Pra, duke qenë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vlerësuar se në rastin konkret i autorizuari i paditësit ka qenë av. Nasuf Hasani nga Prishtina, mirëpo nga shkresat e çështjes rezulton se ai nuk ka pasur autorizim për përfaqësimin e paditësit në këtë procedurë gjyqësore në këtë kuptim rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka ftuar paditësin për seancën e datës 03.11.2020 dhe në këtë rrethanë rezulton i vërtetuar fakti se gjykata gabimisht ka vlerësuar kur ka gjetur se padia e paditësit duhej konsideruar si e tërhequr, ndaj dhe për këtë arsye është dashur që çështja të kthehet në rivendosje me qëllim që gjykata e faktik të ri procedoje çështjen duke u kujdesur për përmbushjen e prezumimeve procedurale pozitive përkitazi me palët ndërgjyqëse-praninë e rregullt të tyre në seancë gjyqësore.

Për arsyet e dhëna si më sipër është dashur që çështja të kthehet për rigjykim në shkallë të parë mbështetur në nenin 209 par.1 pika (d) e LPK-së

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ca.nr.7946/24 me datë 10.09.2024**

**Kryetar i kolegjit-gjyqtari**  
**Enes Mehmeti**